



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë: 16.11.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1613_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_2376_11_22.

në seancën e mbajtur më datë 16.11.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET ankesa e konsumatorit Adnan Salihu ("GURTHYESI KASTRIOTI" SH.P.K) nga Komuna e Shtimes si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi**

A r s y e t i m

Konsumatori *Adnan Salihu ("GURTHYESI KASTRIOTI" SH.P.K)* në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 22.09.2022 ka apeluar përgjigjen e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 30.08.2022 lidhur me kontestimin e faturës për periudhën qershor 2022, për shkak të dyshimit në faturim dhe matje jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 55665133.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 01.07.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën qershor 2022 e përberë nga : **9,872 kWh** për energji aktive, energji reaktive **3,470.24 kVArh**, fuqi **283.68 kW**, tarifën fikse në vlerë **4.62€** si dhe TVSH në vlerë **160.32€** e që në total e shprehur në vlerë financiare **2,164.34€**.

Provë: Fatura nr. 06220DFE-9067147 datë 01.07.2022

Me datë 06.07.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës qershor 2022 me pretendimin se gjatë muajit qershor 2022 Gurthyesi nuk ka punuar fare përkatësisht nuk ka pasur shpenzim të energjisë elektrike.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 06.07.2022

Me datë 28.07.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara në njehsorin elektrik nr. 55665133 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=161,761 kWh dhe TU=16,321 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=139,180 kVAr dhe TU=15,362 kVAr dhe gjendje momentale të maksigrafit 0.2576. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar në procesverbal se behet kontrollimi i Grupit matës dhe nuk është vërejtur ndonjë gabim si dhe merrret gjendja.



është reale dhe se ormani blombohet prapë .

Provë: Raporti mbi kontrollimin-pranimin e Grupit matës nr. 0074508 datë 28.07.2022

Me datë 30.08.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar ne leximet e rregullta dhe rrjedhën e leximeve në AMR(DRO, DV dhe LP) si dhe raportit mbi kontrollimin-pranimin e Grupit matës nr. 0074508 datë 28.07.2022.
Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 30.08.2022

Me datë 22.09.2020 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet fatura per periudhën qershor 2022, për shkak të dyshimit ne faturim dhe matje jo të saktë të njehsorit elektrik nr. 55665133.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 06.12.2020

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 01.07.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën qershor 2022 e përberë nga : **9,872 kWh** per energji aktive, energji reaktive **3,470.24 kVARh**, fuqi **283.68 kW**, tarifën fikse në vlerë **4.62€** si dhe TVSH në vlerë **160.32€** e që në total e shprehur në vlerë financiare **2,164.34€**. Me datë 06.07.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin e periudhës qershor 2022 me pretendimin se gjatë muajit qershor 2022 Gurthyesi nuk ka punuar fare përkatësisht nuk ka pasur shpenzim te energjisë elektrike. Me datë 30.08.2022 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar ne leximet e rregullta dhe rrjedhën e leximeve në AMR(DRO, DV dhe LP) si dhe raportit mbi kontrollimin-pranimin e Grupit matës nr. 0074508 datë 28.07.2022. Në përgjigjën e dhënë po ashtu konsumatori është informuar se fatura e ti duke e pasur parasysh qe i takon grupit tariferor 1/3 përmban: energjinë aktive ne dy tarifate, energjinë reaktive mbi limit ne te dy tarifate dhe fuqinë maksimale(maksigrafite) kW, andaj bazuar ne leximet nga AMR të periudhës qershor 2022 konsumatori ka shpenzim me te theksuar te energjisë elektrike nga data 01.06.2022 deri me datë 06.06.2022, përkatësisht me datë 04.06.2022 është arritur edhe vlera e fuqisë maksimale.

Me datë 28.07.2022 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse te konsumatorit ku kanë evidentuar shpenzimet e regjistruara ne njehsorin elektrik nr. 55665133 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=161,761 kWh dhe TU=16,321 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=139,180 kVAR dhe TU=15,362 kVAR dhe gjendje momentale te maksigrafite 0.2576. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar ne procesverbal se behet kontrollimi i Grupit matës dhe nuk është vërejtur ndonjë gabim si dhe merret gjendja. Gjendja është reale dhe se ormani blombohet prapë.

Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar faturën nr. 06220DFE-9067147 datë 01.07.2022 per periudhën qershor përfshi edhe leximet ne njehsorin elektrik nr. 55665133 si dhe rrjedhjen e fuqisë per periudhën 06/2022 dhe vërteton se përveç energjisë aktive, dhe reaktive po ashtu fuqia



maksimale e arritur per këtë periudhë është me datë 04.06.2022 ku $P=0.3546$. Bazuar ne te gjitha analizat e bëra konstatohet se KESCO me rastin e faturimit te konsumatorit ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*
Provë: Fatura nr. 06220DFE-9067147 datë 01.07.2022

Bordi i ZRRE duke pasur parasysh te gjitha faktet e përmendura me lartë, Raportin mbi kontrollimin-pranimin e Grupit matës nr. 0074508 datë 28.07.2022, leximet mujore te konsumatorit e ne veçanti periudhën qershor 2022 si dhe respektimin e Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.11.2022 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar



Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: **Adnan Salihu ("GURTHYESI KASTRIOTI" SH.P.K)**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.